



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.528/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Getoar Besimit kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Prizren nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur përshkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017 në seancën e panelit të mbajtur me 26.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa lejuar ankesa e Getoar Besimit kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Prizren nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur përshkak të parregullsive gjatë numërimit të votave për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 25.10.2014, nga Getoar Besimit kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Prizren nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) i cili pretendon se me datën 22.10.2017 në tre venvotime janë tjetërsuar votat, kjo për arsye se pas numërimit të votave dhe ngjitjes në FPR në dyert e klasave mungojnë votat e familjareve dhe miqeve të cilt totalsht janë tjetërsuar në FPR. Parashtruesi i ankesës kërkon që të rinumërohen votat në këto vendvotime: 2002A- Ibrahim Femi Arbanë, 2014A- shkolla 11 Marsi, 2033A- shkolla Dëshmorët e Zhurit.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsit në vendvotimet 2002A- Ibrahim Femi Arbanë, 2014A- shkolla 11 Marsi, 2033A- shkolla Dëshmorët e Zhurit, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankuesit Getoar Besimit, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesesit nuk i

mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZLAnr.528/2017 më datën 26.10.2017.



***Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*